

## THE CONCEPT OF ABOLITION IN THE LEGAL SYSTEM OF THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA

**Mitasin Beqiri**

College Biznesi, Prishtina, Kosovo

**Abstract:** Defined as part of the criminal legal matter which is directly regulated by the Constitution of the Republic of Macedonia, abolition or pardon, as a legal institution has gained great popularity, intensity and controversy especially in the recent period of social and political developments in the country. Present on television, in daily and electronic newspapers, this institution has promoted opinions, analysis and debates. Therefore, inspired by the different views of polemicists or experts, I have decided to dedicate this master thesis and related research to this institution.

In the introduction of the topic, as an important basis for further research will be presented the definition of the notion of abolitionist in the Republic of Macedonia as well as the division of specific terminology (which will then help us for the analysis), while regarding declaration of relations or differences between the legal institution of pardon abolition in relation to the legal institution of amnesty.

In any case, the introduction will serve as a basis on which the results obtained from the research will later be built on as an aid in defining and implementing the same. In summary, abolition (pardon) will be studied as an administrative act which annuls or transforms the "functional" identity of the court decision, its legal effect or at least its basic legal effect (ie that which has to do with the criminal sanction), so it is presented as a power over the court, and sometimes even over the law, so this fully justifies the effort to elaborate and analyze the implementation of this institution.

**Keywords:** abolition, legal system, North Macedonia

## KONCEPTI I ABOLICIONIT NË SISTEMIN JURIDIK TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

**Mitasin Beqiri**

Kolegje Biznesi, Prishtina, Kosovo

**Abstrakt:** I përcaktuar si pjesë e materies penale juridike i cili është rregulluar drejtpërdrejt nga Kushtetuta e RM-së, abolicioni ose falja, si institucion juridik ka fituar popullaritet të madh, intensitetin dhe polemika veçanërisht në periudhën e fundit të zhvillimeve sociale dhe politike në vendin tonë. I pranishëm në televizion, në gazeta ditore dhe elektronike, ky institucion ka nxitur mendime, analiza dhe debate. Prandaj për atë shkak, të frymëzuar nga qëndrimet e ndryshme të polemizuesve ose ekspertëve kam ardhur në vendim që këtë punim të masterit dhe hulumtimeve të lidhura me të njëjtën t'ia kushtoj pikërisht këtij institucioni.

Në hyrje të temës, si një bazë e rëndësishme për hulumtime të mëtejshme do të prezantohet edhe përcaktimi i nocionit të abolicionit në Republikën e Maqedonisë si dhe ndarjen e terminologjisë specifike (e cila pastaj do t'na ndihmoj për analizat), ndërsa sa i përket deklaramit të marrëdhënieve apo dallimeve midis institucioni juridik të faljes abolicionit në raport me institucionin juridik të amnistisë.

Në çdo rast, hyrja do të shërbejë si bazë mbi të cilin më vonë do të mbindërtohen rezultatet e fituara nga hulumtimi si ndihmë për përcaktimin dhe zbatimin e të njëjtës. Në përmbledhje do të studiohet abolicioni (falja) si një akt administrativ i cili e anulon ose transformon identitetin "funksional" të vendimit gjyqësor, efektin e tij juridik ose të paktën efektin e saj themelore juridik (d.m.th ajo që ka të bëjë me sanksionin penal), kështu që paraqitet si fuqi mbi gjykatën, ndërsa nganjëherë edhe mbi ligjin, kështu që me këtë plotësisht është i justifikuar përpjekja për përpunimin dhe analizën e zbatimit të këtij institucioni.

**Fjalët kyçe:** abolicionit, sistemi juridik, Maqedonia e Veriut

### 1. INSTITUCIONI JURIDIK I ABOLICIONIT NË RAPORT ME INSTITUCIONIN JURIDIK TË AMNISTISË

*Amnistia* do të thotë dhënie të harresës së një vepre penale sikur asnjëherë të mos ishte bërë." Në aspekt etimologjik fjala amnisti rrjedh nga fjala greke (am-nisti - harresë). *Amnistia* është akt i organit legjislativ dhe kryesisht atë e miraton Kuvendi i një shteti ose cilido organ tjetër legjislativ në përputhje me rregullimin shtetëror. *Amnistia* përkufizohet si një akt i cili miratohet nga organi legjislativ në formën e ligjit me ndihmën e numrit të pidentifikuar

dhe të papërcaktuar njerëzish u jepet *lirim nga përndjekja* penale e plotë ose e pjesshme nga ekzekutimi i dënimit, ose i zëvendësohet dënimi i dhënë me dënim më të butë, ose ju përcaktohet fshirje e dënimit ose ju hiqet pasoja e përcaktuar ligjore e dënimit<sup>188</sup>. Kështu, *amnistia* është akt që i referohet një numri të pacaktuar të individëve të cilët janë të përcaktuar në bazë të kriterëve të caktuara të përgjithshme (për nivel të caktuar të veprave penale, për dënime të caktuara të shqiptuar, etj). Ky është akti me të cilin numrit individual të papërcaktuar të personave ju jepet *lirim* nga ndjekja penale, *lirim* të plotë ose të pjesshëm nga ekzekutimi i dënimit, dënimi zëvendësohet me dënim më të butë, iu lejohet rehabilitimi ose iu shfuqizohen masat e sigurisë. Me fjalë të tjera *amnistia* është akt juridik në formën e ligjit me të cilin për një numër të pacaktuar të personave pozitivisht vendoset në lidhje me statusin e tyre penalo juridik. Që nga pavarësia e saj deri në vitin 2015, *amnistia* e përgjithshme është aplikuar në Maqedoni katër herë. Ligji i parë për amnisti është sjellë në vitin 1991, kur janë amnistuar 907 persona, disa prej të cilëve kanë qenë të burgosur, ndërsa të tjerët u dënuan me vendimeve përfundimtare, por nuk kishin filluar ta vuajnë dënimin me burg. Në vitin 1999, Parlamenti solli edhe një tjetër ligj, por ligj më të kufizuar për amnistinë. Atëherë tërësisht ishin *liruar* nga dënimet kryerësit e veprave të cilët kishin shkaktuar urrejtjen fetare, kombëtare dhe racore. Përveç kësaj, disa të burgosurve ju ishte ulur dënimi me 25%, disave 15%, ndërsa për 10% u janë ulur dënimet e atyre të dënuar për posedim të paligjshëm të armëve dhe trafikut të drogës. Në fakt, ky ligj ishte pjesë e një marrëveshje politike mes partnerëve të koalicionit në qeveri, VMRO-DPMNE dhe PDSH-së, me të cilët janë liruar kryetarët e Tetovës dhe Gostivarit, Alajdin Demiri dhe Rufi Osmani, si dhe pjesëmarrësit për hapjen universitetit të paligjshëm në gjuhën Shqipe në Reçicë të vogël. Në vitin 2002, si rezultat i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, u miratua ligji i tretë për *amnisti*, me të cilin parashikohej *lirim* nga ndjekja penale, pezullimin e procedurave gjyqësore dhe lirimim e të burgosurve lidhur me luftën vitit 2001. Nga ky ligj ishin të përjashtuar vetëm për rastet për krime lufte. Në vitin 2003 dhe me rishikimin nga viti 2004 ishte sjellë ligji i katërt për *amnisti*, i cili i kishte përfshirë qytetarët të cilët ju kanë shmangur shërbimin ushtarak, që nuk iu kanë përgjigjur thirrjes për të shërbyer në ushtri dhe largimin arbitrar nga forcat e armatosura<sup>189</sup>. Nga pikëpamja politike, në lidhje me obligimin e Maqedonisë që ta përmbush kushtin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (t'ju jap *amnisti* të gjithë pjesëmarrësve në trazirat e vitit 2001 palës shqiptare), paraqitet numër i pabesueshëm i problemeve të hapura<sup>190</sup>. Nga *amnistia* dhe *falja* pritet që t'i mundësohet drejtësisë që të bëhet humane, pavarësisht ngurtësisë së verbër të ligjeve; të merren parasysh dyshimet që u mbeten disa dënimeve, edhe pse në parim të gjitha vendimet përfundimtare lidhen me supozimin e pakontestueshëm të drejtësisë se janë të sakta; t'u sigurohet *falje*, në tërësi ose pjesërisht, atje ku ajo e verifikon fillimin e kënaqshëm të ekzekutimit të dënimit (Vouin-Liñauti, 147). Ekzistojnë, pra, situata në jetë kur, për shkak të situatës së ndryshuar socio-ekonomike ose politike në vend, bëhet plotësisht e padrejtë dhe nganjëherë edhe absurde këmbëngulja në kryerjen e gjyqime të caktuara përfundimtare (si për shembull, mund të theksohen vepra të përmendura që në ndërkohë janë shfuqizuar). A ka kuptim që të këmbëngulet në zbatimin e vendimeve që lidhen me veprat penale tashmë të shfuqizuara kur vetë shoqëria e ka vlerësuar se ata më nuk përbëjnë kërcënim? Ndonjëherë justifikimi i këtyre institucioneve duhet detyrimisht të kërkohet në disa interesa të veçanta shtetërore (politike): një person mund të jetë kapur në flagrancë në aktivitetin e spiunazhit, dhe shteti megjithatë nuk dëshiron t'i sakrifikojë marrëdhëniet e mira dhe bashkëpunimin e vetë me vendin e të cilit i takon spiuni për koston e sjelljes së atij para gjyqit dhe dënimin e tij. Ndonjëherë, edhe pse për personalitetin delikuent lidhen meritat individuale nga e kaluara ose shpresat e mëdha që talenti i tij të veçantë (muzikë, letrar, etj) që i ofron atdheut. Një tjetër herë këto institucione mund të përdoren për shkak të arritjes së qëllimeve kriminale-politike: të jetë nxitje për sjellje të mira të burgosurit, të themi, ata që e dinë se mund të fitojnë që dënimi t'u *falet* (pjesërisht ose plotësisht). Dhe diçka më shumë se kaq: Mëshira përbën pranimin e faktit se bota jonë nuk është vetëm bota e drejtësisë (sipas motos "*Fiat iustitia, pereat mundus*", le të jetë drejtësia, edhe me çmimin që bota të shkatërrohet), por, pavarësisht drejtësisë, ekzistojnë edhe vlera të tjera që mund të kenë nevojë që të ndihmohen për t'u nderuar kundrejt drejtësisë<sup>191</sup>. Më tutje, vjeshtën e vitit 2015 janë iniciuar dy nisma të veçanta për ligjin e pestë mbi *amnistinë*, të parashtruara nga Aleanca Demokratike dhe nga aktivistja qytetare Meri Nikollova e cila arriti t'i mbledh 10,000 nënshkrimet e nevojshme për propozimin e saj që të hyjë në procedurë ligjore, por propozim ligji nuk u miratua, për shkak se ka parashikuar lirimim e të gjithë personave që kanë vuajtur 40% të kohës së dënimit, duke i përfshirë edhe vrasësit, pedofilët dhe

<sup>188</sup> Gaberov Ass. Mr., M., „Abolicioni si instrument juridik“, Universiteti i Evropës në R.M-së. – Fakulteti për shkencat juridike, Qershor, 2016.

<sup>189</sup> Lubisha Arsiq, „VMRO-DPMNE trembet nga amnistia që të mos ballafaqohet me Lube Boshkovskin!“, *Fokus*, nr 1043, 2.10.2015.

<sup>190</sup> Marijanoviq, Gjorgje, „*Amnistia dhe falja*“, data 08.03.2002.

<sup>191</sup> Vlatko Stojanovski, „DPMNE dhe kanë penguar amnistinë me ligj që të falin vrasës përmes Ivanovit!“, *Fokus*, nr 1058, 15.1. 2015.

autorë të tjerë të krimeve të rënda. Nga ana tjetër, propozimi i Aleancës Demokratike, i cili gjithashtu hyri në procedurën parlamentare, sugjeroi *lirim* ose *zvogëlim* e dënimit të kryerësve të krimeve të caktuara që kanë vuajtur një pjesë të dënimit, ose aspak nuk ka filluar mbajtjen e dënimit. Kështu, sipas këtij propozimi ishte parashikuar që të *lirohen* të dënuarit për veprën penale "kontrabandim të emigrantëve", të cilët ishin të dënuar me burgim deri në tre muaj, ndërsa ata të cilët e kanë bërë këtë veprë penale si pjesë e grupit dhe të atyre që janë dënuar me burg për gjashtë muaj ishte parashikuar zvogëlimi i dënimit për 50%. Për më tepër, propozim ligji parashihte zvogëlim të dënimit për 33% (nga pjesa e pavuajtur e dënimit) për të dënuarit me dënim deri në një vit dhe për të dënuarit për veprën penale të "dhënies ose marrjes së ryshfetit." Për ata të dënuar që parashikojnë dënim me burg deri në 10 vjet (pengimin e zgjedhjeve, ryshfetit gjatë votimit, plaçkitjet e rënda, krime kundër shëndetit dhe të mjedisit, krimin financiar, mashtrimeve të rënda, etj) ishte parashikuar reduktimin e gjobës me 25% nga pjesa e pavuajtur, d.m.th 10% e pjesës së pavuajtur (për ata që janë përsëritës të krimeve të përmendura). Së fundi, projektligji ka parashikuar që personat e moshës 60 vjeçare dhe të cilët ishin dënuar me burgim deri në pesë vjet, t'u zvogëlohet dënimi për 40% të pjesës së pavuajtur. Megjithatë, *amnistia* e propozuar nuk vlen për të dënuarit me burg prej 10 vjet ose më shumë, për të dënuarit me burgim të përjetshëm, dhe ata të dënuar për vrasje, veprat penale kundër shtetit, krime kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare për krime kundër lirisë seksuale dhe moralit seksual, prodhimit dhe trafikimit të drogave dhe të njëjta. Megjithatë, propozim ligji nga Aleanca Demokratike nuk e fitoi shumicën në parlament dhe nuk u votua. 22

## 2. INSTITUCIONI I DREJTËSISË ABOLICIONI NË RAPORT ME INSTITUCIONIN E DREJTËSISË FALJE DHE AMNISTI

*Amnistia* dhe *falja* mund të ketë kuptim më të gjerë, ato mund të përfshijnë lirim nga ndjekja penale, që do të thotë t'i pamundësohet që kryerësit të krimit të shqiptohet dënim për padi penale. Kjo formë e *amnistisë* ose *faljes* quhet *abolicion*. Termi *abolicion* në aspekt etimologjik vjen nga gjuha latine. *Abolicion* do të thotë *heqje*, *anulim*, në përgjithësi, dhe kjo e vënë në fjalorin legjislativ është në thelb *lirim* nga ndjekja penale, heqje dorë nga proceset gjyqësore. Kjo praktikisht do të thotë "mungesë të caktuar të gjykimit." Termi *abolicion* vjen nga fjala latine *abolere* - *shkatërron*, dhe paraqet përjashtim nga ndjekja penale e personave të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm se janë autorë të veprave penale. Etimologjikisht, termi "*abolicion*" e ka prejardhjen nga latinishtja dhe do të thotë *heqje* apo *anulim* në përgjithësi, ndërsa në aspektin juridik nëpërmjet këtij termi do të thotë lirim nga ndjekja penale apo pezullimin e ndjekjes penale. *Abolicioni* ose siç është emri latin i origjinal "*abolere*", përkufizohet si lirim nga ndjekja penale për një person që është nën dyshimin se kanë kryer veprë penale. Vetë termi i *abolicionist* në realitet implikon dhe e thekson faktin e "*mungesës së gjykimit*," respektivisht mos sjellje të vendimit përfundimtar gjyqësor në një rast penal për ndonjë person tjetër. Për shkak të faktit se termi "*abolicion*" është term i gjerë dhe i njëjti i përfshin edhe *amnistinë* dhe *faljen* si akte mëshirës së shtetit në këtë pjesë të njëjtit, paralelisht do të analizohen me të gjitha tiparet dhe karakteristikat e tyre<sup>192</sup>. Kështu, personi i përfshirë me *abolicion* nuk do të ndiqen penalisht, bile edhe nëse ekziston dyshim i arsyeshëm. Ky institucion nuk është vetëm "veçori" e jona, por edhe

përdoren edhe në korniza botërore. Një nga shembujt më të njohura të *abolicionit* është me presidentin amerikan Richard Nixon, i cili më 9 gusht, 1974 dha dorëheqjen për shkak të mega aferës "*Watergate*". Pasardhësi i tij, Gerald Ford, pas arritjes në Shtëpinë e Bardhë, nënshkroi një dekret me të cilën e abanoi Niksonin për vepra penale eventuale të kryera gjatë kësaj afere. E vëzhguar në një gjenezë historike, *abolicioni* si institucion juridik është përdorur që nga shekujt e vjetër, sistemin juridik në Babiloni, në sistemet juridike të Greqisë së lashtë, sistemi juridik i Romës së lashtë përmes Mesjetës e deri më sot. Përmes aplikimit të *abolicionit*, në fakt shteti e thekson të drejtën e faljes përmes mëshirës ndaj të dyshuarve dhe kryesve të akuzave të veprave penale, si dhe të drejtën që e njëjta të përdoret në situatë të caktuara. Heqja dorë nga e drejta shtetërore e dënimit është e përfaqësuar në Legjislacionin juridik-penal që nga kohët më të hershme<sup>193</sup>. Për institucionin e *amnistisë* dhe të *faljes* dhe aplikimit të tyre në legjislaturën e shteteve të vjetra është karakteristike ajo se të njëjtit nuk kanë njohur ndarje të këtyre dy institucioneve, në aspekt terminologjik siç është sot, por të dy termat kanë sugjeruar në faktin e lirisë nga ndjekja penale, edhe pse në praktikë ishte pranuar termi i lirim. Nga aspekti historik institucioni juridik i *faljes* haset shumë kohë më parë, akoma në burimet e para juridike të organizatave shtetërore. Është karakteristik për legjislaturën e Greqisë së lashtë, Babilonisë, Romës dhe të tjerëve. Pasojat juridike nga zbatimi i këtij institucioni atëherë dhe sot nuk dallohen dhe të njëjtit i referohen lirim nga persekutimi, i vetmi dallim është në faktin se sot *amnistia* paraqet akt nga natyra e përgjithshme me ndihmën e së cilës *amnistohen* me emër rreth i pacaktuar i personave, derisa e

<sup>192</sup> 23 Gaberov Ass. Mr., M., "*Abolicioni si instrument juridik*", Universiteti i Evropës në R.M-së. – Fakulteti për shkencat juridike, Qershor, 2016.

<sup>193</sup> Ibid

njëta gjë në kaluarën është aplikuar si akt për lirim nga ndjekja penale për persona të caktuar për vepra të caktuara penale. Kjo qasje e cila është miratuar në të kaluarën për aplikim të veçantë të *faljes* për vepra të caktuara penale janë konfirmuar edhe nga Kodi i Hamurabit, kështu në këtë kuptim i njëjti kodë si ndëshkim për gruan që ka bërë tradhti bashkëshortore e përshkruan dënimin me vdekje me hedhjen e saj në ujë, por megjithatë burri i saj ka të drejtë që njëjtën ta *falë*, nëse shfrytëzohet kjo e drejtë e implikon edhe të drejtën e mbretit për *falje* të mëtejshme të të dashurit. - Kodi i Hamurabit, 1760 BC<sup>194</sup>. Amnistia (bashkë me *faljen*) është e njohur nga kohët e lashta e këndej. Kjo është një nga institucionet më të vjetra në mëshirën e sovranit. Kanti do të thotë: më e ndjeshme në mes të drejtave të sundimitarit. Në të dyja rastet (edhe te *amnistia* edhe te *falja*) bëhet fjalë për vendim të heqjes dorë të shtetit nga e drejta e dënimit për veprat penale të kryera. Abuzimet e mëdha të mëshirës së sovranit në të kaluarën janë bërë nga *falja*, kryesisht institucion legal juridik shumë të diskutueshëm, që ishte kritikuar ashpër nga arsimuesi (Bekarija veçmas) dhe *falja* LP / 1791 revolucionare franceze. *Falja* zyrtarisht ishte arsyetuar me mos-pajtueshmërinë e tij me parimin e ndarjes së pushteteve: me këtë shefi ekzekutiv i pushtetit intervenon në një çështje gjyqësore. Shpjegimi themelor qëndron në përpjekjen e parandalimit të prishjes së drejtësisë në të ardhshëm përmes *faljeve* arbitrare dhe të papranueshme. Megjithatë, asnjë rregullim nuk mund në afat më të gjatë të heq dorë nga këto dy institucione. Bamirësia është valvuli i sigurisë së domosdoshme të drejtësisë. Saktësisht dhe formalisht e shikuar në aspekt juridik ekzistojnë dallime në institucionet e *amnistisë* dhe *faljes*. Këto dallime janë evidente si në aspektin e atyre që janë kompetent për miratim, edhe në drejtim të rrethit të personave të cilëve ato zbatohen, dhe për pasojat juridike të cilat i prodhojnë. Kështu, diferenca e parë në raport me ata që janë kompetent që t'i sjellin dhe të vendosin për *amnisti* dhe *falje* të çon në formulimin e procedurave të ndryshme. *Amnistia* sillet në formën e ligjeve nga ana e organit legjislativ (Parlamenti, Kuvendi Parlamenti ...) ndërsa *falja* është akt i Presidentit i dhënë me vendim ose dekret. Megjithatë, pavarësisht dallimeve mund të perceptohen edhe ngjashmëri, sepse të dy institucionet janë në përgjegjësi e një pushteti të rendit më të lartë, edhe atë të organeve jo-gjyqësore të cilët në realitet me aktet e tyre e ndryshojnë vendimin e gjykatës. Në këtë mënyrë të dy institucionet janë "ndërrhyrje kirurgjikale" e "indit" të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv. Një tjetër ndryshim mes institucionit për *amnisti* dhe *falje* është në aspektin e numrit të personave të cilit iu referohet. Derisa *amnistia* sillet në formën e ligjit dhe vepron në numër të pacaktuar (në parim numër më i madh i njerëzve), *falja* është gjithmonë i referohet personit të saktë me emër. Prandaj, për *amnistinë* thuhet se është e përgjithshme dhe abstrakte, ndërsa për *faljen* thuhet se është individuale dhe konkrete. Është e qartë se ekzistojnë dallime por edhe ngjashmëri në mes të këtyre dy institucioneve që janë të dukshme. *Amnistia* dhe *falja* mund të thuhet se janë me veprimspecifik të organeve jashtëgjyqësore që shërbejnë për të ndryshuar pasojat nga vendimet gjyqësore në favor të të pandehurit. Edhe *amnistia* edhe *falja* janë të rezervuara për organet më të larta shtetërore. Ata përfaqësojnë "diskrecionin e këtyre organeve." Ekziston ngjashmëri të dukshme e këtyre institucioneve edhe në aspektin e veprimit juridik që që e prodhojnë atë. Edhe *amnistia* ose *falja* prodhojnë efekte të ngjashme juridike, ndërsa nganjëherë mund edhe të përputhen. Me krahasimin e tyre vijmë në përfundim se *falja* sot prodhon efekt më të gjerë juridik të *amnistisë*, edhe pse ajo nuk ka qenë gjithmonë kështu<sup>195</sup>.

### 3. PËRFUNDIMI

Sepse përqendrimi i këtij punimi është i orientuar drejtë gjendjes dhe zhvillimeve në Republikën e Maqedonisë, siç tregohet edhe nga përmbajtja e hulumtimit pas implementimit të saj do të vazhdohet me analizën e rregullimit legjislativ të *abolicionist* në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë. Rregullimi juridik i *abolicionit* në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë do të njihet në fillim përmes prezantimit të përcaktimit kushtetues të *abolicionist*, gjegjësisht *falja* si pjesë nga përgjegjësitë e Presidentit të Republikës së Maqedonisë - *Presidenti i Republikës së Maqedonisë me falje jep çlirimin nga ndjekja penale, të plotë ose lirim të pjesëshëm nga ekzekutimi i dënimit, e zëvendëson dënimin e shqiptuar me dënim më të lehtë ose me masa alternative ose e përcakton fshirjen e dënimit, ose përcakton kohëzgjatje më të shkurtër të pasojës së caktuar juridike të ndëshkimit ose dënimit*. Pavarësisht përcaktimit kushtetues, ky institucion ka përcaktim ligjor me atë që është i rregulluar me ligj të veçantë - Ligji për *falje*, përcaktimi i tij ligjor dhe udhëzimet janë edhe te ligjet tjera, si që janë Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, Ligji për procedure penale dhe Ligji për shqyrtimin e gjobave. Përkufizimi i përkatësisë institucionale në masë të madhe do të ndihmojë për kuptimin e plotë të procedurës për *abolicionin*, zbatimin e tyre, rrjedha dhe kompetencat në këtë segment të Ministrisë për drejtësi përmes departamentit për *falje* dhe kompensim të demit dhe Komisionit për *falje*, e cila është organ i punës së Presidentit të Republikës së Maqedonisë, i cili punon në seancat e thirrura nga Presidenti i Komisionit me iniciativën e vetë por edhe në bazë përfundimit të Komisionit. Komisioni në

<sup>194</sup> Gaberov Ass. Mr., M., „*Abolicioni si instrument juridik*“, Universiteti i Evropës në R.M-së. – Fakulteti për shkencat juridike, Qershor, 2016.

<sup>195</sup> D. Miladinoviç, „*Falja në legjislativën e Serbisë*“, teza e magjistraturës, Novi Sad, 2006.

seanca i shqyrton individualisht çdo kërkesë për *falje* dhe jep mendim për të gjitha propozimet e parashtruara nga ministri i drejtësisë dhe propozimeve për *falje* që i kanë dorëzuar zyrtarisht.

#### LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- Арсик, Љ. (2015). „ВМРО-ДПМНЕ се плаши од амнестија за да не се соочи со Љубе Бошкоски!“, *Фокус*, број 1043, 2.10.2015.
- Габеров, М. (2016). „Аболицијата како правен институт“, Европски Универзитет Р.М. – Факултет за правни науки
- Маријановиќ, Ѓ. (2002). „Амнестија и помилување“, 08.03.2002 година.
- Стојановски, В. (2015). „ДПМНЕ и спречија амнестија со закон за дапомилуваат и убијци преку Иванов!“, *Фокус*, број 1058
- Chartrand, V., & Piché, J. (2019). Abolition and pedagogy: reflections on teaching a course on alternatives to punishment, state repression and social control. *Contemporary Justice Review*, 22(1), 23-42.
- McLeod, A. M. (2018). Envisioning Abolition Democracy. *Harv. L. Rev.*, 132, 1613.
- Miladinović, D. (2006). „*Pomilovanje u krivičnom zakonodavstvu Srbije*“, magistarska teza, Novi Sad
- Roberts, D. E. (2019). Abolition Constitutionalism. *Harv. L. Rev.*, 133, 1.

#### Burimet e shkruara

- Kushtetuta e RM-së nga viti 1991
- Ligji për *falje* (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 93/2009)
- Udhëzim për veprimet e gjyqeve dhe institucionet ndëshkuese –korrektuese sipas lëndëve për *falje* (Gazeta zyrtare e RM-së nr.39/1993)
- Ligji për plotësim i Ligjit për *falje* („Gazeta zyrtare e RM-së “nr.. 99/2016)
- Vendim për *falje e Kryetarit të RM-së* (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 72/2016)
- Vendimi i Gjyqit Kushtetues të RM-së U.nr. 19/2016-0-0, nga marsi i vitit 2016
- Kodi penal i RM-së
- Shënime stenografike nga mbledhja e njëzetë e Kuvendit të RM-së, e mbajtur më 25 prill 2003.
- Propozim Ligj për plotësimin e Ligjit për *falje*, procedurë e shkurtuar, Shkup, Maj 2016.